



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 26.06.2013

Nr. 0204-754

**PËR:** Bekim Mehmeti, përfaqësues i qytetarëve të fshatit Vojnovcë, Komuna e Shtimes

**LËNDA:** Përgjigje në Ankesë

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datën 11.06.2013, ka pranuar nga Bekim Mehmeti, përfaqësues i qytetarëve të fshatit Vojnovcë, një ankesë, kundër vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/124 të datës 31.05.2013, lidhur me mos realizimin e kërkesës së qytetarëve në fjalë për ndërrimin e emrit të një rruge me emrin "Fejzullahu" në "Tre Dëshmorët e Kërçovës".

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ankesës së qytetarëve të fshatit Vojnovcë të komunës së Shtimes ka konstatuar se:

- Është në mandatin ligjor të Kuvendit të Komunës që të vendosë emërimin final të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike, ashtu siç është paraparë me pikën (o) të nenit 17, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
- Vendimet komunale duhet të jenë transparente dhe t'i nënshtrohen një procesi të konsultimi paraprak, ashtu siç është paraparë me Kreun IX të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimit administrativ Nr. 2008/09 "Për Transparencën në komuna".

Nëse eventualisht keni ndonjë kërkesë plotësuese jemi në dispozicionin Tuaj për ta trajtuar, bazuar në mandatin ligjor që kemi si Ministri

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL**

**Kopje:** Naim Ismaili, Kryetar i Komunës Shtime  
Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Datum: 01.07.2013

Br. 0204-754

**Za :** Bekim Mehmeti, predstavnik građana sela Vojnovce, Opština Stimlje

**Predmet:** Odgovor na žalbu

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je dana 11.06.2013, primilo od Bekim Mehmeti, predstavnik građana sela Vojnovce, kalbu protiv Odluke Skupštine Opštine Stimlje Npi-01/124 od dana 31.05.2013, u vezi sa nerealizacijom zahteva gradajna za promenu imena jedne ulice po imenu "Fejzullahu" na " Tre Dëshmorët e Kërçovës-Tri pala boraca Kičeva".

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandator odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja žalbe građana sela Vojnovce Opštine Stimlje je konstatovalo:

- U zakonskom je mandatu Skupštine Opštine da imenuje finalno ulice,i druga javna mesta,onako kako je predvidjenosa tačkom (o) člana 17, Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu;
- Opštinske Odluke treba da budu transparentne i podležu jednom procesu prethodne konsultacije, kako je predvidjeno prema Poglavlju IX Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu i Administrativnog Uputstva br. 2008/09 "O Transparentnosti u Opštinama.

Ako eventualno imate dopunski zahtev mi smo na raspolaganju za tretiranje istog,na osnovu zakonskog mandata kojeg imamo kao Ministarstvo.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,  
Zamanik premijera & Ministar MALS-a

**Kopija:** Naim Ismaili, Gradonačelnik Opštine Stimlje  
Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a  
Rukovodiocima Uprava MALS-a  
Arhivi MALS-a



## MINISTRISË SË PUSHTETIT LOKAL

### PRISHTINË

FYRESESI-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA ADOVA REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVES И АДМИНИСТРАЦИЈА ИТАЛИЈА			
QEVERIA E KOSOVES И АДМИНИСТРАЦИЈА ИТАЛИЈА GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministria e Lokalne Samouprave i Administracije			
Ministry of Local Government Administration			
Data			
Datim 11.06.2013			
Data			
Titulli i funksionit			
- III -			
Nr. i Lendës			
0204-754			
Shifra			
3			
Vlera			

**LËNDA :** Ankesë kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Shtimes Npi-01/124 të datës 31.05.2013 për shkak të qëndrimit të prerë për refuzim të kërkesës së qytetarve të fshatit Vojnovcë duke mos dhënë sqarimet përkatse

Në vendimin refuzues, te cekur më lart, Kuvendi Komunal nuk i dha sqarimet për refuzim të kërkesës 01 Nr.07/934 të fshatarve të Vojnovcit (të ushtruar në bazë të autorizimit me shkrim të fshatarve nga Bekim Mehmeti) në të cilën kërkohet ndryshimi i emërimit familjar "Fejzullahu" meqenëse është në kundërshtim me pikën 1.4 të nenit 9 të "Ligjit për Sistemin e Adresave" dhe që në vend të këtij emertimi joligjor ti jepet rrugës emri "Tre Dëshmoret e Kërçovës". Kuvendi Komunal për këtë vendim refuzues shprehet vrazhdësisht se e mori pasi që "analizoj kërkesën dhe rekomandimet e Komitetit Politik dhe Financa" dhe kështu vendosi që të mbetet pranë vendimit të mëparshëm 01 Nr.06/766-80 të dt.05.04.2013 në të cilën bënë heqjen e emertimit të "Dëshmorve të Kombit" duke mos theksuar se emertimi i "Tre Dëshmorve të Kërçovës" pranohet apo jo në vend të emërimit të hequr.


Nëse instancat kompetente nuk e respektojnë ligjin dhe kërkesën legjitime të fshatit ne qytetarët e Vojnovcit vendosmërisht do të zbatojmë ligjin për të hequr emërtimet joligjore dhe në vend të tyre të shënojmë: rruga e "Tre Dëshmorve të Kërçovës" që përjetsisht të respektojë heroizmat e divizionit "Skenderbeg" të cilët për ta mbrojtur Kërçovën nga fashizmi Bullgarë në vitin 1943 i bënë nderë kombit dhe fatkeqësisht u vranë shumë Kosovarë në mesin e të cilve ishte togeri Sadik Mehmeti dhe ushtarët Arif Shabani dhe Mustafë Bajrë Mehmeti që të tre nga fshati Vojnovc.

Për vrasjen e dëshmorve Kosovarë në këtë betejë tani disa familjar të këtyre dëshmorve posedojnë fakte të reja të marrura së voni në Kërçovë, Gostivar, Shkup dhe Dibër nga historianët dhe qytetarët e moshuar.

Vojnovc 11.06.2013

Ankesa i Dorzohet një kopje:

- Ministrisë të Pushtetit lokal
- Kuvendin Komunal Shtimes
- (të ciles i bashkangjitet materiali shtesë për dëshmi ) për media.

Me nderime  
Bekim Mehmeti  
  
(Person i autorizuar)



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME  
01Nr.006/2512, Datë: 22.5.2013



Nr/1 - 01/124, Datë: 31.5.2013

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër: 01Nr.07/934, datë:23.04.2013, të z.Bekim Mehmeti nga fshati Vojnove, i cili ka kërkuar ndryshimin e emërimit të rrugës "Fejzullaha" në fshatin Vojnove që është emërtuar me vendimin e Kuvendit Komunal, 01Nr.06/766-80 të datës 05.04.2013, dhe kanë kërkuar me disa nënshkrime të banorëve që të emërtohet rruga "Tre Dëshmorët e Kërçovës", me arsyetimin e tij se vendimi i Kuvendit është marrë në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit për sisteminin e adresave Nr.04/07-071 i cili thotë: Ndalimet e Emërtimeve: 1. Emrat e mëposhtme nuk do të përdoren në lidhje me Zonat e Qarkullimit Publik: 1.1. inicialet, shkurtetat dhe emrat e shkurtuara; 1.2. emrat në gjuhët e huaja; 1.3. emra që përmbajnë gabime gjuhësore; 1.4. emrat e familjeve; 1.5. emrat përshkrues; 1.6. emrat që përdorin numra nuk duhet të përdorin numrat me fraksione. Nëse nuk përfillen kërkosa jonë ne do të bëjmë ankesë në instancën më të lartë administrative. Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS 01Nr.07/934  
TË BEKIM MEHMETIT NGA FSHATI VOJNOVC**

**I**

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2013, të mbajtur më datën: 31.5.2013, me shumicën e votave ka vendosur që të refuzoi kërkesën me numër: 01Nr.07/934, të z.Bekim Mehmeti nga fshati Vojnove, me arsyetimin se Kuvendi Komunal, ka vendosur për këtë çështje

**II**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit  
Kujtim Xhelili





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi  
Uprava za Urbanizam, Katastar i Geodeziju  
Department of Urban Planning, Cadastre and Geodesy

Data/Datum/Date:	25.03.2013
Nr./Br./No	06/28
Për/Za/To:	Bekim Mehmeti-Vojnovc
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Komisioni për emërtimin e rrugëve dhe shesheve-Shtime Kordinatore: Shqipe Rexhaj
Lënda/Predmet/Subject :	NJOFTIM

Duke u bazuar në kërkesën me nr.01/07/360 të Bekim Mehmeti nga Vojnovci për ndryshimin e disa emrave të rrugëve në fshatin Vojnovc si dhe të futën emrat e Dëshmoreve në disa rrugë, komisioni për emërtimin e rrugëve ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe ju njofton:

1. Që emri "Dëshmoret e Kombit" gjendet në një rrugë tjetër dhe me Ligjin nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave" nuk mund të jetë në dy rrugë brenda territorit të komunës.
2. Tre dëshmorët e fshatit që ranë në luftën e fundit janë përfshirë në emërtimet e rrugëve në fshat.
3. Dhe kërkesa për mbetjen e emërit të Sylejman Mehmeti mbetet ashtu si ka qen, dmth e aprovuar.

Ne qytetarët e Vojnovcit nga lagjet: Burrënikët, Kurtovitë, Bajrovitë, Muhaxherët, Mehmetovit, Pleshinakët, hasanovit, Aslanovit.

### PROPOZOJMË

Që rruga kryesore e fshatit Vojnovc të quhet rruga: "Tre Dëshmorët e Kërçovës"

Arsyetimi (historiku i shkurtër)

Disa muaj para kapitullimit të fashizmit Gjermanë me propozimin e udhëheqësisë ushtarake Gjermane formohet divizioni "SKENDERBEG" nga radhët e "Rinisë patriotike Shqiptare". Financimi i shkollimit të ushtarakëve të këtij divizioni është bërë nga njësitë Gjermanë në Prishtinë, si ç'shihet me motiv që pas largimit të Gjermanisë shqiptarët e Kosovës të mos bëhen viktimë e riokupimit Serb. Shkollimi është bërë në Prishtinë në ndërtesën e renovuar në rrugën për ball ndërtesës ku gjendej "Ministria e Energjetikës dhe Minierave të Kosovës".

Si duket gjasat për këtë qëndrim revoltues Gjerman janë në revoltën ndaj serbëve, ~~që~~ që nga lufta e dytë botërore, me që se kanë vrarë dhe shpërngul më shumë se 200.000 Gjerman nga trojet e tyre etnike në Baçka Pallanka dhe Baçka Topolla e Vojvodinës.

Me rastin e kapitullimit të Italisë Fashiste në vitin 1943. Fashizmi Bullgar filloi të shtrihet në zonën okupuese në teritoret shqiptare të cilat ishin të okupuara më parë nga Italianët.

Rezistencën kundër okupimit Bullgar e organizoi Xhem Gostivari (Mufaili i Vogël), i cili për të përballuar mbrojtjen e Kërçovës nga sulmet Bullgare i thirri në ndihmë patriotët Kosovar.

Nga radhët e divizionit "Skenderbeg" u lajmërua togu ushtarak në krye me togerin Sadik Mehmeti dhe kësaj grupe vullnetarisht ju bashkuan rreth 60 ushtar të tjerë nga divizioni "Skenderbeg".

Në luftën mbrojtëse të Kërçovës përveq tjerëve është vrarë togeri Sadik Mehmeti, Mustafë Bajra (Mehmeti) dhe Arif Shabani që të tretë nga Vojnovci. Në këtë luftë të përgjakshme ka patur të vrarë nga të dy palët konfrontuese si nga ana e shqiptarëve por edhe të Bullgarëve.

Mu për këtë ne qytetarët e fshatit Vojnovc dëshirojmë që në shenjë të respektit të emërtojmë rrugën kryesore rruga e "TRE DËSHMORËT E KËRÇOVËS"

Për një praktikë të ngjashme, sa për krahasim vlen të përkujtohet që në Tiranë gjendet rruga "Tre Dëshmorët e Vigut" në Paris gjendet rruga e "Heronjëve të Renesanses Zhan Andri Dynah"

-Në përputhje me nenin nent (9) të ligjit nr.04/L-071 "për sistemin e adresave" ne qytetarët e Vojnovcit kundërshtojmë që të bëhen emërtimet e rrugëve në emra familjar të lagjeve si p.sh rruga Burrënikve, rr Mehmeti rruga e Muhaxherve, rruga Fejzovit etj.

**P.S-Me këtë kërkesë qytetarët e Vojnovcit do të njoftojmë edhe mjetet e informimit në Kosovë dhe më gjerë.**

Vojnovcë (Komuna e Shtimes): 15.04.2013

*B. Mehmeti*

PASOJNË NËNSHKRIMET: